

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë mbi Ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 1

1 E martë, 22 korrik 2025

2 [Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes

6 videolidhjes]

7 --- Seanca fillon në orën 14.01

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

9 Sekretare, mund të paraqisni lëndën.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar

11 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i

12 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep

13 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita, të

15 gjithëve. Vërej që z. Krasniqi po na ndjek përmes

16 videolidhjes. Ndërkohë që të akuzuarit e tjerë janë të

17 pranishëm në sallën e gjyqit. Po ashtu, për procesverbal, them

18 që znj. Alagendra dhe znj. Rowan po na ndjekin përmes

19 videolidhjes.

20 Vendosëm që të mbanim një seancë të shkurtër për ecurinë

21 e çështje në mënyrë të tillë që të bënim një përmbledhje të

22 synimeve tona lidhur me vazhdimin e kësaj çështjeje dhe për të

23 marrë komentet dhe sugjerimet tuaja dhe, mbase më shumë

24 rëndësi, të dëgjonim në qoftë se ka probleme që akoma nuk janë

25 zgjidhur përpara se të vazhdojmë në fazën tjetër të gjykimit

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë mbi Ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 2

1 që do të fillojë me konferencën për përgatitjen e Mbrojtjes që
2 do organizohet menjëherë pas fundit të pushimit të verës.

3 Kjo seancë nuk është një seancë zëvendësuese për seancën
4 sipas rregullës 118. Kjo seancë, ashtu si seancat e tjera për
5 ecurinë e çështjes, është e ngjashme me to, qëllimi kryesor
6 është që të kemi një panoramë të përgjithshme për progresin
7 dhe planifikim. Si gjithmonë, mezi presim të dëgjojmë komentet
8 tuaja.

9 Një rend i ditës me shkrim është qarkulluar të premten.
10 Do të mundohemi që të bëjmë të pamundurën që të trajtojmë të
11 shtatë pikat në rendin e ditës sipas rendit e përcaktuar në
12 atë rend dite.

13 Përpara sesa të kalojmë tek pika e parë, Trupi Gjykses
14 dëshiron që të nxjerrë një urdhër që ka të bëjë me
15 klasifikimin e mocionit të Mbrojtjes sipas rregullës 130 dhe
16 parashtimet e lidhura.

17 Më 12 qershor 2015, Mbrojtja dorëzoi një mocion sipas
18 rregullës 130 me numër F032560. Më 16 korrik 2015, Trupi
19 Gjykses lëshoi në seancë publike vendimin e vet lidhur me
20 F03256. Sipas rregullës 82(5), duke vënë re se parashtimi
21 3256 është dorëzuar në versionin konfidencial dhe për të
22 siguruar deri në masën e mundur një gjykim publik, Trupi
23 Gjykses urdhëron Mbrojtjen që ose të kërkojë riklasifikimin
24 ose të dorëzojë versionin publik të redaktuar të parashtimit
25 F03256 deri të premten 22 gusht 2025.

1 Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se në parashtrimin
2 F03314, datë 7 korrik 2025, ZPS-ja kërkoi riklasifikimin e
3 parashtrimit F03314 dhe të shtojcës së saj si publik. Pasi
4 rishikoi parashtrimet përkatëse, Trupi Gjykses miraton
5 kërkesën e ZPS-së dhe urdhëron Zyrën Administrative që të
6 riklasifikojë F03314 dhe F03314/A01 si publike.

7 Këtu përfundon urdhri gojor i Trupit Gjykses.

8 E di që z. Misetic, që është përfaqësuesi i z. Thaçi,
9 përmes mesazhit elektronik ka kërkuar që të dëgjohet në fillim
10 të kësaj konference për ecurinë e çështjes.

11 Kështu që fjalën e keni ju. z. Misetic.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
13 Faleminderit, të gjithëve.

14 Dua që të ngre disa çështje të cilat do t'ju japin
15 informacion lidhur me të gjitha pyetjet që na keni bërë deri
16 tani dhe do të mundohem që jap përgjigjet për të gjitha
17 pyetjet në mënyrë që të mos çohem më gjatë seancës. Sa i takon
18 kohës që ka kaluar ose periudhës së gjashtë javëve të fundit,
19 dua që të ritheksoj edhe një herë mënyrën sesi e kemi kuptuar
20 ne historikun procedural.

21 Në konferencën për ecurinë e çështjes, më 22 janar 2025,
22 në transkriptin në faqen 24342 deri në 24343, Mbrojtjes iu bë
23 pyetja se sa kohë do të duhet që të paraqesë provat e saj dhe
24 sa kohë do të duhet për të bërë përgatitjen e Mbrojtjes pasi
25 të merret një vendim për rregullën 130 dhe fillimit të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë mbi Ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 4

1 çështjes së Mbrojtjes dhe ne, të gjitha ekipet e Mbrojtjes,
2 kërkuam dhjetë javë nga koha kur do të jepej vendimi sipas
3 rregullës 130, duke përjashtuar pushimin e verës.

4 Ndërkohë në konferencën e radhës për ecurinë e çështjes
5 më 19 shkurt 2025, në transkript në faqen 25462, Mbrojtja e
6 Veselit, më konkretisht z. Dixon, i kërkoi Trupit Gjykues në
7 qoftë se udhëzimet që u kishim kërkuar në konferencën për
8 ecurinë e çështjes në janar lidhur me përgatitjen për provat e
9 Mbrojtjes se ishte e pranueshme për Trupin Gjykues, përgjigja
10 e Trupit Gjykues ishte që në përgjithësi këto afate ishin të
11 pranueshme.

12 Kështu që, Ekipet e Mbrojtjes kanë marrë përgjigje nga
13 Trupi Gjykues që ato kanë të drejtë që të kenë dhjetë në
14 dispozicion për përgatitjen e prova të tyre pasi të merrej
15 vendimi sipas rregullës 130, duke mos marrë parasysh këtu
16 pushimin e verës.

17 Ndërkohë që Trupi Gjykues, gjithashtu, nuk na ka bërë
18 asnjë njoftim por ka ndryshimin e tij, na ka dhënë një rend,
19 një tjetër parashtrim që është F03232, që Trupi Gjykues
20 *proprio motu* përcakton afatet për aspektet e provave të
21 Mbrojtjes, duke përfshirë kështu edhe ofrimin e dëshmitarëve
22 dhe të listës së provave materiale, më 21 korrik 2025 dhe,
23 gjithashtu, ka vendosur edhe për konferencën për përgatitjen e
24 Mbrojtjes për pjesën tjetër të gjykimit.

25 Ndërkohë, më datë 23 qershor, ZPS-ja i është përgjigjur

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë mbi Ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 5

1 kërkesës tonë duke kundërshtuar ndryshimin dhe, po ashtu, ZPS-
2 ja kërkoi që Trupi Gjykues të lëshonte një tjetër urdhër të ri
3 sa i takon afateve kohore përfshirë këtu edhe përmbushjen e
4 detyrimeve për nxjerrje të materialeve sipas rregullës 104(5)
5 dhe të jepte informacionin që kërkohet sipas paragrafit 74 të
6 Urdhrit për Zhvillimin e Procesit.

7 Mbrojtjet dorëzuan një kundërpërgjigje të përbashkët më
8 26 shtator duke theksuar gjithashtu edhe shkakun e arsyeshëm
9 që qëndron në bazë të mocionit tonë dhe që kundërshton
10 kërkesën e ZPS-së që kërkon afate të reja. Një prej arsyeve që
11 është dhënë nga Ekipet e Mbrojtjes është Mbrojtja duhet të
12 ketë mundësinë e barabartë që të dëgjohet sipas afateve kohore
13 përkatëse.

14 Më 2 korrik, Trupi Gjykues lëshoi vendimin F03302, duke e
15 kundërshtuar, duke e rrëzuar kërkesën tonë për ndryshim të
16 afateve në përjashtim të datës për konferencën për përgatitjen
17 e Mbrojtjes. Trupi Gjykues gjithashtu vendosi disa afate të
18 tjera të kërkuara nga ZPS-ja pa dëgjuar parashtimet përkatëse
19 të Mbrojtjes. Po ashtu edhe lëshoi disa afate të tjera shtesë.

20 Sipas këtij urdhri, Mbrojtja e Thaçit, duke qenë se z.
21 Thaçi është i akuzuari i parë në aktakuzë, është urdhëruar që
22 të jetë gati që të paraqesë provat e veta duke filluar nga
23 java e 25 gushtit 2025. Trupi Gjykues, përmes këtij vendimi,
24 ka zbritur ose ka reduktuar kohën në dispozicion të Mbrojtjes
25 për të përgatitur çështjen e vet me dhjetë javë, siç ishte

1 planifikuar dhe, në vend të 15 tetorit, ka vendosur që çështja
2 e Mbrojtjes së Thaçit të fillojë më 25 gusht. Dhe ndërkohë, e
3 gjithë kjo është bërë pa asnjë lloj njoftimi nga shkurti deri
4 në qershor duke mos marrë fare parasysh vështirësitë që ka
5 Mbrojtja për përmbushjen e afateve përkatëse.

6 Parashtrimi ynë nuk është që nuk na keni dëgjuar, sepse
7 ju keni pasur mundësi që të na dëgjoni ne në konferencat që
8 janë organizuar në shkurt dhe në prill por Mbrojtja i ka
9 kërkuar konkretisht se çfarë mendon Trupi Gjykues dhe në qoftë
10 se autorizon këtë afat kohor prej dhjetë javësh nga marrja e
11 vendimit sipas rregullës 130 dhe shprehimisht Trupi Gjykues ka
12 thënë që përgjithësisht kjo është e pranueshme. Gjithashtu, të
13 akuzuarit kanë të drejtë që të kundërpërgjigjen. Në pranimin e
14 gjerë të Trupit Gjykues sa i takon kërkesës për dhjetë javë -
15 çfarë i takon që ky afat kohor do jetë diku nga 10 tetori -
16 duke përfshirë këtu edhe afatet për kërkesa sipas rregullës
17 107.

18 Në një tjetër pikë të lidhur, më duhet të them, që Trupi
19 Gjykues e ka ulur kohën për përgatitjen e Mbrojtjes nga dhjetë
20 javë në dy javë dhe kjo ka krijuar shumë barrë të shtuar dhe
21 vështirësi për ekipin tim i cili ka punuar dhe vazhdon të
22 punojë rreth 12 orë në ditë, në mënyrë të tillë që të mundohet
23 që të respektojë afatet përkatëse.

24 Ne nuk jemi në dijeni në qoftë se Trupi Gjykues apo
25 Gjykatësi i Procedurës Paraprake ndonjëherë e ka trajtuar ZPS-

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë mbi Ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 7

1 në një mënyrë të tillë, që ka vendosur afate për nxjerrjen
2 e dokumenteve ose për fillimin e provave të ZPS-së, pa i dhënë
3 ZPS-së mundësinë që të dëgjohet. Për procesverbal, dëshiroj të
4 them që këto janë afatet të cilat kanë krijuar shumë
5 vështirësi për përgatitjen e Ekipeve të Mbrojtjes dhe, sikurse
6 e kemi diskutuar dhe më herët, ne kërkojmë që të na jepet
7 mundësia që të shpjegohet se pse ne nuk na është miratuar e
8 drejta jonë për të pasur afatet kohore përkatëse, të paktën
9 siç i kemi kuptuar ne këto afate dhe siç ato lidhen me siç ato
10 lidhen me rregullën 107, me ofruesit e informacionit sipas
11 rregullës 107.

12 Ju faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe unë i bashkohem parashtimeve
15 dhe dëshiroj të them që në seancën e datës 23 prill, në faqen
16 26167, ju, i nderuar Gjykatës, njohët përpjekjet e të gjitha
17 palëve në mënyrë të tillë që të respektojmë afatet kohore
18 gjithashtu edhe që të kapim ritmin siç ai është kapur deri
19 tani.

20 Në ekipin tim, ashtu siç edhe në rastin e z. Misetic, ne
21 kemi punuar në mënyrë të jashtëzakonshme për të respektuar
22 afatet e përcaktuara prej jush. Dhe, për rrjedhojë, i
23 bashkohemi parashtimeve të z. Thaçi dhe parashtrojmë që ne
24 nuk jemi në gjendje që të fillojmë provat për klientin tonë më
25 datë 25 gusht dhe arsyet për këtë do t'jua jap pak më vonë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokuroria?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Shumë shkurtimisht. Më lejoni të
3 them që, sipas pikëpamjes tonë, diskutimi për dhjetë javët
4 duhet të tejkalohet kur flasim për atë se çfarë kërkon
5 Mbrojtja kur i është paraqitur rendi i ditës.

6 Mbrojtja ka thënë më datë 13 qershor 2025, që Mbrojtja ka
7 mundësi që të fillojë të thërrasë dëshmitarin e parë në javët
8 që fillojnë të hënë, domethënë, më 15 shtator 2025.

9 Dhe, në fakt, kjo është shumë më pak sesa dhjetë javë.
10 Dhe ky është afati kohor që kanë kërkuar ekipet e Mbrojtjes.
11 Dhe ky afat edhe për ne është i nevojshëm që të përgatitemi.
12 Sipas nesh, ky afat kohor do ishte i mjaftueshëm për t'i dhënë
13 të gjitha palëve mundësinë që të përgatiten dhe për të qenë
14 fleksibël.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, keni
16 ndonjë gjë për të shtuar?

17 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kam gjë për të shtuar.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e di
19 anëtarët e Trupit Gjykses? Në qoftë se kanë ndonjë koment ose
20 sugjerim për të shtuar?

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndoshta për të plotësuar
22 kronologjinë që na dhatë ju, z. Misetic, dua të them sa më
23 poshtë. Më datë 1 tetor 2024, juve iu bë pyetja sa kohë ju
24 duhet që të përgatisni provat tuaja dhe ju jeni përgjigjur:

25 "Katër deri gjashtë javë, më mënyrë të tillë që ne të

1 bëjmë përgatitje për dëshmitarët.”

2 Domethënë, këtë keni thënë më datë 1 tetor 2024.

3 Tjetra pikë që dëshiroj që të ngre me ju, z. Misetic,
4 është se koha që është kërkuar sipas kërkesave sipas rregullës
5 130. Në rregullore parashikohen dhjetë ditë dhe pas kërkesës
6 tuaj, ne kemi miratuar zgjatjen e afatit që u kërkuar prej jush
7 dhe juve ju dha në dispozicion gjashtë herë më tepër kohë që
8 është parashtruar në rregullore.

9 A e kam kuptuar drejt që një pjesë e përgatitjes për
10 provat e Mbrojtjes është bërë gjatë kësaj periudhe kohe?

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Në përgjigje të pyetjes tuaj, tani
12 sa i takon asaj çfarë kam thënë në tetor, tetori është shumë
13 herë më përpara sesa konferencave të tjera që unë përmenda pak
14 më përpara, në konferencat e mëpasshme ne kemi diskutuar për
15 dhjetë javë, nuk kemi diskutuar për asnjë afat tjetër.

16 Sa i takon aspektit të dytë, sigurisht, që ne kemi
17 punuar, kemi punuar gjatë gjithë kohës që kemi pasur në
18 dispozicion. Megjithatë, kjo nuk ndryshon asgjë lidhur me
19 faktin që ne kemi funksionuar ose kemi punuar ndryshe nga
20 regjimi që ne kemi rënë dakord me juve në shkurt. Edhe sa për
21 ta sqaruar nuk është që po kërkoj një zgjatje deri në mes të
22 tetorit. Por dua që ju ta kuptoni që ne kemi punuar duke
23 menduar që do fillojmë provat tona në mes të tetorit. Duke
24 menduar që ndoshta Trupi Gjykses do ta shkurtonte këtë kohë
25 por jo kaq shumë e jo të na kërkonte që të fillonim që në

1 gusht.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic edhe një herë,
3 këto diskutime kanë të bëjnë me mocionin sipas rregullës 130.
4 Në qoftë se i kam bërë siç duhet llogaritjet, nga koha që janë
5 mbaruar provat nga Prokuroria, janë mbyllur këto prova dhe nga
6 momenti që filloni ju me dëshmitarët tuaj, i takon që ju keni
7 pasur katër muaj në dispozicion për përgatitje, e kuptoj që
8 një pjesë të kësaj kohe ju e keni shpenzuar për të përgatitur
9 mocione sipas rregullës 130.

10 Megjithatë, kam bërë ca krahasime me çështje të tjera që
11 janë të së njëjtës madhësi. Dhe, sinqerisht, unë nuk kam
12 gjetur shumë ose asnjë që ka qenë aq shumë bujar sa i takon
13 afateve, përfshirë dhe disa çështje ku keni qenë ju të
14 përfshirë, z. Misetic.

15 Kështu që, pyetja ime për ju do ishte kjo: Sa kohë
16 mendonit ju që do të merrnit nga momenti që Prokuroria mbaroi
17 me provat e veta deri në momentin që ju do filloni me provat
18 tua?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Së pari, nuk e di fare se për
20 çfarë çështjesh e keni fjalën ju, Gjykatësi Mettraux,
21 megjithatë, ne kemi të bëjmë me ofruesin sipas rregullës 107
22 për të cilin do duhet të marrim autorizim dhe ky është problem
23 shqetësues.

24 Së dyti, në qoftë se ky është arsyetimi juaj, dua të di
25 arsyen pse s'na e keni thënë këtë gjë në mars, në prill apo në

1 maj, por këtë gjë na e keni thënë për herë të parë më datën 7
2 qershor.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk mendoj se më duhet
4 t'ju jap përgjigje për pyetjen, megjithatë, prezumimi im është
5 që kohën që e keni pasur të nevojshme që ta përdorini për
6 mocionin sipas rregullës 130, do e kishit përdorur për
7 përgatitjen e provave tuaja. Për shembull, për sa i takon
8 çështjeve që thatë që nuk e dini për çfarë çështjesh flas unë,
9 flas për çështjen Gotovina ku keni pasur 25 dëshmitarë. Ju
10 është dhënë dy javë, jo gjashtë javë ose tetë javë, që keni
11 kërkuar sipas kërkesave të 98 *bis*, dhe gjithashtu ju është
12 dhënë një periudhë kohore po ashtu më e shkurtër edhe në një
13 çështje tjetër dhe për sa i takon numrit, sa gjysmës së numrit
14 të dëshmitarëve që ju keni në këtë çështje gjyqësore.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Pyetja që kam për juve është kjo:
16 Sa prej këtyre dëshmitarëve përfshijnë ofruesit sipas
17 rregullës 107?

18 Ajo çfarë dua të them është që nga dëshmitarët që i kemi
19 nxjerrë ne juve që nuk kërkojnë autorizim sipas rregullës 107,
20 ne mund të fillojmë provat e Mbrojtjes, po e kemi problemin
21 kryesisht këtu me dëshmitarët sipas rregullës 103, pra, që
22 duhet autorizimi.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tre.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, është dëshmitar sipas 153. Ne
25 kemi dy dëshmitarë. Në qoftë se është e mundur që t'i sjellim

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë mbi Ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 12

1 ata më 25 gusht. Kjo është një tjetër çështje që duhet
2 diskutuar së bashku me Zyrën për Mbrojtjen e Dëshmitarëve.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duket sikur
4 problemi kryesor i juaji sa i takon përgatitjes së çështjes
5 tuaj janë dëshmitarët sipas 107-s, apo jo?

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kujtoj që
8 kur z. Kehoe ishte në vendin tuaj, dy vite e ca më përpara, ai
9 tha që ishte i gatshëm që këta dëshmitarë t'i sillte nesër që
10 të jepnin dëshmi këtu. Thjesht e sajoi, e tha nga mendja e vet
11 këtë gjë apo vërtet ishte i përgatitur që këto dëshmitarë t'i
12 kishe gati për të dhënë dëshmi?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] E kemi marrë korrespondencën nga
14 ofruesi sipas rregullës 107 dhe na duhet autorizim për këtë.
15 Ka një proces që duhet respektuar.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
17 ishit gati ju ta bënit menjëherë, pra, t'i sillnit këto
18 dëshmitarë që të nesërmen, atëherë pse nuk e keni të mundur që
19 t'i sillni këta?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Ky realiteti është --

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fakt,
22 Kehoe e ka thënë këtë gjë që ditën e parë që ka ardhur këtu në
23 Gjykatë.

24 Se kjo nuk është e qartë për ne, pas dy vitesh e gjysëm
25 po na thoni tani që nuk keni marrë ende autorizimin? Se ju

1 ishiti gati të fillonit që para dy vitesh e gjysëm me procesin.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe vështirësia është që
3 procesi, për të paktën gjysmën e dëshmitarëve të propozuar, ka
4 filluar në tetor të 2022, për gjysmën e tyre. Pra, nëse na
5 thoni tani që ende s'keni marrë autorizime sipas rregullës 107
6 dhe kjo do të vonojë çështjen, unë e kam të vështirë ta kuptoj
7 dhe ta pranoj.

8 Do flas edhe për aspektet ligjore të 107-s, po
9 megjithatë, kjo është mënyra si kanë rrjedhur gjërat. Ka
10 filluar, pra, në tetor të 2022. Dhe në janar 2023 e njëjta
11 listë na u paraqitë ne. Dy e treta, aso kohe, janë të njëjtat
12 persona që keni paraqitur dhe ju tashmë.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Edhe një herë, ka arsye për këtë,
14 disa për këtë është se ka pasur proces tjetër për autorizimin
15 e intervistave dhe autorizim tjetër për ato që janë përdorur
16 në Gjykatë. Disa prej këtyre dëshmitarëve e kanë ndjekur çfarë
17 kemi bërë se kanë dëgjuar çfarë ka paraqitur Prokuroria.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ju i keni paraqitur si
19 dëshmitarë para shumë kohësh. Nuk po flasim për intervistat. E
20 dimë ne dallimin. Po janë ofruar si dëshmitarë në kohën
21 përkatëse.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse i sillni ju, atëherë këtu,
23 megjithëse nuk marrim ne autorizimin, atëherë le ta bëjmë. Por
24 më vjen keq, po e përsërisë këtë. Nëse kështu e keni menduar
25 ju, kjo ka qenë mendësia juaj, keni pasur për synim të

1 shkurtoni kohën, duhet të na kishit thënë sepse ne jemi bazuar
2 në atë që keni thënë në shkurt dhe pse nuk na keni thënë që do
3 ta shkurtonit këtë kohë nga shkurti deri në qershor, por e
4 marrim vesh papritmas në qershor që keni shkurtuar afatet për
5 ne. Unë këtë nuk e shpjegoj dot.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Misetic, që ta keni të
7 qartë, do t'ju lexoj diçka që ke nga një dokument i 28 tetorit
8 2022. Paragrafi 23:

9 "Të gjithë dëshmitarët që ka kontaktuar Mbrojtja janë të
10 disponueshëm në shkurt të 2023-s, me përjashtim të njërit që
11 do të jetë i disponueshëm në prill 2023."

12 Pra, pyetja ime është shumë e thjeshtë: Kur filloi
13 procesi i autorizimit për rregullën 107, kur filloi si proces,
14 kur e filluat ju procesin e autorizimit?

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Po ka disa hapa për autorizim
16 sipas rregullës 107. Ka filluar që në hapat e para të kësaj
17 çështjeje gjyqësore, u kërkua autorizimi por u mor vetëm për
18 disa intervista të dëshmitarëve. Diku nga pranvera e këtij
19 viti, kur vendosëm të thërrisnim disa prej këtyre dëshmitarëve
20 në gjykatë, i bëmë kërkesën zyrtare ofruesve të informacionit
21 në mënyrë që të na i jepnin autorizimin përkatës.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ama në dokumentin e 28
23 tetorit 2022, duket sikur në atë datë ekipi juaj ishte gati të
24 fillonte me dëshmitarët -- nuk donte t'i thërriste këta
25 dëshmitarë - më falni.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë mbi Ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 15

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo. Ne e kishim të qartë që do t'i
2 thërrisnim dëshmitarët. Po nuk kishim marrë autorizimin prej
3 tyre që do të vinin si dëshmitarë në Gjykatë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky procesi
5 duhet të kishte filluar më shpejt. Jeni me vonesë për këtë.
6 Për këtë s'ka asnjë diskutim.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund ta thoni që jemi me vonesë,
8 por unë mund t'ju them që ne kemi ecur me afatet e shkurtit të
9 këtij viti dhe kishim menduar që këta persona do të kishin
10 përfunduar me procesin e autorizimit për këta persona deri më
11 15 shtator.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju nuk e
13 dini as sot këtë. As nuk e dini as nëse do të jeni gati më 15
14 shtator?

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk e dimë. Kur ta marrim vesh
16 do ju njoftojmë. I kemi diskutuar dhe *ex parte* këtë, do ju
17 njoftojmë dhe në qoftë se nuk e marrim autorizimin atëherë do
18 kërkojmë ndihmën tuaj që të mundësohet autorizimi prej
19 ofruesve të informacionit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis,
21 keni diçka për të shtuar ju lidhur me këtë?

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Unë thjesht për procesverbal dua të
23 them, se e kemi bërë të qartë më duket edhe në një dokument
24 tonin, nuk është kaq e thjeshtë, nuk është se s'kemi punuar ne
25 për mocionet e rregullës 107.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë mbi Ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 16

1 Në kohën kur kemi dorëzuar mocionin, kemi pasur dhe 44
2 mocione të tjera me të cilat po punonim që duhet t'i
3 shqyrtonim, duhet t'i rishikonim përpara se të jepnim
4 përgjigjet përkatëse. Nuk mund të thoni që Mbrojtja u ul edhe
5 priste të merrte vendim. Ne kemi punuar jashtëzakonisht shumë
6 gjatë kësaj kohe.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe ne kemi
8 punuar në të njëjtën kohë.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Pa diskutim.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
11 Alagendra, a keni ju diçka për të shtuar lidhur me këtë? Në
12 rregull.

13 Ka gjë tjetër nga Trupi Gjykses?

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ngaqë po flasim për
15 rregullën 107, z. Misetic, jam pak i paqartë për mënyrën si e
16 interpretoni ju rregullën 107 dhe mbase do të duhet ta
17 diskutojmë së bashku që të kuptohemi të paktën me njeri-
18 tjetrin.

19 Me sa kuptoj unë, ju po propozoni, dhe i referohem
20 parashtimit që keni dorëzuar dje dhe ne e morëm sot, F03357,
21 është parashtimi që dorëzuar dje, më 21 korrik pra, mesa e
22 kuptoj unë ju thoni ose nuk jeni të autorizuar ose nuk jeni të
23 detyruar të jepni emrat e dëshmitarëve të mundshëm që janë
24 objekt i autorizimeve sipas rregullës 107. A e kam kuptuar unë
25 drejt këtë gjë?

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk janë të autorizuar, jo të
2 detyruar, jo të autorizuar.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Keni ndonjë burim juridik
4 ju për këtë? I kam lexuar parashtrimet tuaja, më duket se
5 është poshtëshënimi 8 i dokumentit tuaj, që ju po mbështeteni
6 në pozicionin që kishte ndërmarrë dhe Prokuroria të paktën për
7 një dëshmitar, pra edhe ju mendoni se për shkak se e ka bërë
8 Prokuroria edhe ju keni të drejtën të mos i jepni të dhënat
9 për këtë person?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Më vjen keq, unë nuk e dija që do
11 më kërkonit precedent tani, unë mund të shkoj dhe ta kërkoj
12 informacionin përkatës dhe t'ua dërgoj. Çështja është që të
13 paktën sipas perspektivës tonë nuk ka ndonjë precedent në
14 tribunalet penale për këtë, por, sidoqoftë, ne marrim parasysh
15 pozicionin e ofruesit të informacionit sipas rregullës 107. Ky
16 është shqetësimi ynë.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por në tetor 2022 dhe
18 janar 2023, ju i keni dhënë gjysmat e këtyre emrave, ia keni
19 dhënë ZPS-së këto emra, Gjykatësit të Procedurës Paraprake aso
20 kohe edhe Panelit, Trupit Gjykues.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Problemi është ky, çfarë ka
22 ndodhur në të shkuarën, mirë a keq, nuk do të thotë që ne
23 duhet të vazhdojmë të veprojmë në mënyrë të gabuar, ofruesit e
24 informacionit ma kanë bërë të qartë mua si avokat që duhet
25 ndjekur një procedurë.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirë a keq, është diçka që
2 e vendosim ne, z. Misetiç. Problemi është që ju tani po
3 argumentoni, të paktën siç e kuptoj unë dhe thoni që ka -- nuk
4 kemi të drejtë ta nxjerrim këtë informacion ndërkohë që ky
5 informacion tashmë është nxjerrë. Ky informacion tashmë i
6 është nxjerrë palës kundërshtare.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk po argumentoj aspak. Po
8 përpigem të jem sa më shumë bashkëpunues me ofruesit e
9 informacionit sipas rregullës 107 në mënyrë që të sjellim
10 dëshmitarët. Nëse do të më jepni urdhër që ta nxjerr
11 informacionin, unë do ta respektoj urdhrin tuaj. Ama nuk marr
12 përsipër pasojat që do të ketë kjo për ofruesit e
13 informacionit sipas rregullës 107, kjo është një problematikë
14 që do të duhet ta trajtojë më pas Trupi Gjykses dhe do të
15 merrni ju përsipër përgjegjësi për këtë.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Prandaj po jua ofrojmë
17 mundësinë të na thoni cila është baza ligjore, kush është
18 burimi, precedenti për këtë. Keni bërë dhe një parashtrim
19 tjetër në dokumentin tuaj, paragrafi 4, dokument i dorëzuar
20 dhe, thatë, përmbledhjet e dëshmitarëve të propozuara, sipas
21 jush, janë të parakohshme.

22 E njëjta pyetje sërish: Ju i keni nxjerrë tashmë disa
23 prej këtyre përmbledhjeve, të paktën për gjysmën e
24 dëshmitarëve të propozuar. Çfarë ka të parakohshme këtu? Dhe e
25 keni nxjerrë informacionin që para dy vitesh e gjysëm.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Po përsëris dhe një herë atë që
2 thashë, nëse diçka është bërë në mënyrë të gabuar para dy
3 vitesh e gjysëm, nuk do të thotë që ne do vazhdojmë të
4 veprojmë në mënyrë të gabuar.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur keni
6 komunikuar për herë të fundit me ofruesit sipas rregullës 107?

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne komunikojmë çdo javë. Edhe
8 madje dhe dje komunikua me ta, i pyetëm cili është qëndrimi i
9 tyre edhe përgjigja që morëm ishte që: Jemi duke punuar.
10 S'kemi asnjë përgjigje të mëtutjeshme.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ju kanë
12 dhënë ndonjë afat?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo. Por ua kemi thënë që na është
14 vendosur afati për datën 18 gusht dhe t'i nxisim që të punojnë
15 pak më shpejt. Po në disa institucione ka burokraci të
16 caktuara, gjërat zvarriten sidoqoftë.

17 Është dhe problemi i çështjes së pushimeve të verës,
18 besoj që do të jetë edhe më e vështirë që të realizohet kjo
19 gjatë periudhës së verës, t'ju kërkosh personave që punojnë në
20 institucione të veprojnë në mënyrë efikase. Por, unë nuk kam
21 informacion të brendshëm sesi funksionojnë proceset në
22 institucione apo agjencitë përkatëse.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju, z.
24 Ellis, a do të ishit ju i gatshëm të fillonit, a do të
25 fillonit ju atëherë me dëshmitarët tuaj në mënyrë që t'i japim

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë mbi Ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 20

1 kohën përkatëse ekipit të z. Misetic derisa të marrin
2 informacionin nga ofruesit e 107?

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, jo. As ne nuk jemi gati të
4 fillojmë. Mund t'ju jap detaje të mëtejshme nëse m'i kërkon,
5 por përgjigja ime për momentin është jo nuk jemi të gatshëm.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk kam
7 nevojë për parashtrime të thelluara. Faleminderit.

8 Trupi Gjykses do të trajtojë pikën e parë në rendin e
9 ditës që është në korrik 2025, Mbrojtja e z. Thaçi dhe z.
10 Krasniqi, përkatësisht informon Trupin Gjykses në bazë të
11 rregullës 119, që do të paraqesë në mbrojtje dëshmitarë.

12 Edhe të hënën Ekipi i Mbrojtjes i z. Thaçi dhe z.
13 Krasniqi dorëzuan listën e dëshmitarëve të provave materiale
14 sipas rregullës 119(2), me parashtrimet përkatëse F03357,
15 F03358.

16 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses dëshiron të konfirmojë me
17 Mbrojtjen e z. Thaçi dhe z. Krasniqi se dokumentet që janë
18 dorëzuar dhe janë tërësia e dokumenteve që synojnë të përdorin
19 Ekipet e Mbrojtjes sipas rregullës 119(2).

20 Z. Misetic, fillimisht ju, ju lutem.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Kemi dorëzuar një listë të
22 dëshmitarëve dhe një listë të provave materiale që përmbushin
23 kriteret e rregullës 119(2) por kjo vlen vetëm në qoftë se nuk
24 do të duhet të marrim autorizim sipas rregullës 107.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kam të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë mbi Ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 21

1 qartë këtë. Do t'i dorëzoni të gjitha këto prova materiale apo
2 disa do të kërkohen të pranohen apo sipas rastit?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Kjo e fundit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa prej tyre
5 do të kërkoni që t'i pranojmë përmes dëshmitarëve?

6 Z. MISETIC: [Përkthim] E morëm urdhrin tuaj të enjten dhe
7 me vëllimin e punës që kemi pasur ne, nuk kemi pasur mundësi
8 ta lexojmë urdhrin tuaj dhe nuk jemi në gjendje t'ju japim
9 hollësi për këtë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
11 përdorni mocionin e provave jогоjore?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Sa mendoni se do të pranohen
13 përmes provave jo gojore?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk mund t'ju jap përgjigje lidhur
15 me këtë. Do të jetë në varësi të dëshmitarëve dhe çfarë do të
16 ngelet pastaj për t'u trajtuar më pas.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis, do
18 t'i përgjigjeni dhe ju të njëjtës pyetje?

19 Z. ELLIS: [Përkthim] E njëjta gjë dhe për ne. Kemi
20 dorëzuar listën e dëshmitarëve, listën e provave materiale.
21 Për momentin nuk parashikojmë të dorëzojmë gjë të mëtutjeshme.

22 Lista e provave materiale është relativisht e shkurtër,
23 vetëm një pjesë të vogël të materialeve do t'i kërkojmë të
24 pranohen përmes dëshmitarëve. Të tjerat do kërkojmë të
25 pranohen ose përmes mocioneve jo gojore ose mund të mos i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë mbi Ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 22

1 kërkojmë fare që të pranohen si prova gjyqësore. Do përpigemi
2 të shfrytëzojmë sa më shumë për mocionin për prova jo gojore,
3 po s'e kemi vendosur, nuk e kemi vendosur në mendje si do të
4 veprojmë. Por të paktën një nga mocionet për provat jo gojore
5 për mocionet që ju ka ngelur të pa trajtuara do të jetë në
6 fund të paraqitjes së provave për ne.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
8 të njëjtën praktikë do të ndiqni edhe ju?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni të lexoj pak
10 transkriptin.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, desha
12 t'ju pyesja do t'i dorëzoni nga fundi mocionet tuaja
13 përkatëse?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Ditën e fundit, datën e fundit që
15 do të na caktoni ju si afat do të dorëzojmë mocionet tona.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Do të bëjmë dhe ne disa
17 parashtime lidhur me këtë pikë, nëse mund të na i pranoni?

18 Fillimisht, sa i takon listës së dëshmitarëve besoj se
19 tashmë është e qartë. Lista e dëshmitarëve të z. Thaçi për ne
20 nuk është ndonjë problematikë se nuk kërkon ndonjë vëllim të
21 madh pune, megjithatë ka një problem se emrat e dëshmitarëve
22 janë të redaktuar.

23 Vetëm tre emra janë të qartë. Emri i parë në listë, në
24 fakt, e bën të qartë që Mbrojtja e Thaçit nuk e ka kontaktuar
25 këtë dëshmitar. Ne këtë dëshmitar nuk kemi për synim ta

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë mbi Ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 23

1 përdorim më fare për provat tona gjyqësore.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, redaktoni këtë nga
3 transkripti. E kemi bërë të qartë në parashtimet tona që disa
4 emra nuk duhet të paraqiten ose më saktë disa informacione nuk
5 duhet të jenë publike.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjithë
7 deklaratën thoni?

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Parashtimi i protokolluar
9 është konfidencial, z. Misetiç.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Besoj se nuk thashë asgjë
11 konfidenciale në parashtimin tim.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, po, por ajo pjesa ku thoni:

13 "... dëshmitar të cilin s'kemi për synim ta përdorim më
14 si dëshmitar të Prokurorisë ..."

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
16 [Përkthim] Në rregull, do ta shikoj këtë çështje.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Ne nuk mund të përgatitemi në këtë
18 situatë për dëshmitarët e Mbrojtjes.

19 Në listën e provave materiale janë dy probleme që mendoj
20 që duhet t'i theksojmë. Dhe, në fakt, janë, vlejné për të dyja
21 listat. Së pari, nuk është praktikë e mirë të kesh referenca
22 të ndërlydhura në një listë të provave materiale. Të dy ekipet
23 e Mbrojtjes kanë bërë, domethënë, kanë përdorur dhe referenca
24 të Prokurorisë në listën e tyre të provave materiale.

25 Rregulla 119(2) (b) kërkon që Mbrojtja të bëjë një, të

1 ketë listë të provave të propozuara dhe do të na ndihmonte dhe
2 ne mënyrë që punonim për dokumentin, të dimë ne çfarë
3 dokumentesh do të kërkojë Mbrojtja që të paraqiten dhe të
4 pranohen përmes paraqitjes së provave të tyre.

5 Ata nuk mund të veprojnë në këtë formë. Mbrojtja e Thaçit
6 citon një rast në mocionin e tyre, që është çështje e
7 Tribunalit Penal Ndërkombëtar që nuk ka fare ngjashmëri me
8 këtë çështje gjyqësore apo me procesin tonë gjyqësor edhe nuk
9 mund të krahasohet nga pikëpamja procedurale me çështjen tonë
10 si referencë.

11 Sa i takon listës së provave është -- po ashtu dua të
12 them që kohën e kemi pasur shumë të kufizuar dhe jo çdo gjë
13 është e përkthyer në anglisht në listën e tyre të provave
14 materiale s'i kanë të gjitha përkthimet përkatëse. Veç kësaj,
15 ndonëse rregulla 102(3), 103, e bën të qartë dhe thotë që ZPS-
16 ja nuk e ka për detyrë që t'i përkthehen materialet, unë
17 mendoj që në mënyrë që të bëjmë punën siç duhet është mirë që
18 të na japin dhe versionet në anglishte të materialeve që do
19 synojnë të pranohen si prova gjyqësore. Dhe mendoj se kjo
20 është diçka që duhet të zgjidhet nga palët në mënyrë që ne të
21 bëjmë punën siç duhet.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
23 Mettraux ka një pyetje.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po filloj me ju z.
25 Halling. Dhe kam të njëjtën pyetje që i bëra dhe z. Misetic,

1 sa i përket rregullës 107.

2 A ka ndonjë burim ligjor, sipas jush, ndonjë precedent
3 për faktin që Mbrojtja duhet t'ju japë ju emrat dhe
4 përmbledhjen e dëshmitarëve të propozuar për dëshmitarët që
5 janë objekt i autorizimit sipas rregullës 107?

6 Z. HALLING: [Përkthim] Ne mendojmë që këto janë çështje
7 se materiali vjen ofrues pas ofruesi. Arsyeja pse nuk e dhamë
8 ne emrin e dëshmitarit sipas rregullës 107 është sepse na e
9 kërkoi specifikisht ofruesi. Por duhet të ketë një arsye të
10 vlefshme për këtë.

11 Dhe nuk e kemi të qartë, të paktën në bazë të atyre që
12 tha Mbrojtja e Thaçit, nëse është vërtetë pengesë prej
13 ofruesit të informacionit kjo. Nëse lexojmë paragrafin 4 të
14 parashtimit F03357, është një koment atje ku thotë që:

15 "Nëse deklaratat nuk do të marrin autorizimin përkatës,
16 Mbrojtja do të thërrasë dëshmitarët *live*, pra, të japin dëshmi
17 në sallën e gjyqit, çka do të thotë që do të rritet dhe do të
18 duhet të shtohet afati për dëshmitarët e Mbrojtjes."

19 Por nuk është e qartë pse nuk mund të na jepen emrat ne.
20 Ne na duhen emrat sa më shpejt që të jetë e mundshme në mënyrë
21 që të respektojmë dhe ne detyrimet tona dhe të përgatitemi për
22 këta dëshmitarët.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam dhe disa pyetje për
24 ekipet e Mbrojtjes tani, kjo lidhet me listën e provave
25 materiale. Formulimi i përbashkët që keni ju në parashtimet,

1 formulime të ngjashme në parashtrimet tuaja dhe i referoheni
2 rregullës 119 dhe thoni që janë prova materiale që mund t'i
3 përdorni ose t'i paraqisni në sallën e gjyqit. Formulimi i
4 rregullës nuk është që mund, nuk mund të thoni "mund".

5 Z. Misetic, ka një paqartësi këtu, shqetësimi që kam unë
6 është nëse e keni menduar tamam siç duhet vërtet e keni
7 menduar që do ta përdorni të gjithë materialin apo thjesht po
8 përpigëni të përfshini nja 4.000 dokumente dhe një prej jush
9 dhe 1.000 ekipi tjetër dhe më pas të mos i përdorni të gjitha.

10 Desha t'ju pyes dhe një herë synoni ta përdorni tërësinë
11 e materialeve që keni paraqitur në listën tuaj? Dhe,
12 gjithashtu, sa u takon dokumenteve të ZPS-së, nuk jam shumë i
13 qartë në fakt lidhur me parashtrimin tuaj në këtë drejtim.
14 Prandaj do të isha pak më i qartë.

15 Pra, po thoni nuk keni përfshirë në listën e propozuar të
16 provave materiale dokumentet që janë në listën e provave
17 materiale të ZPS-së? Dhe, nëse po, cili është precedenti, në
18 bazë të cilës rregulle e keni bërë ju këtu? Sepse rregulla për
19 mua është shumë e qartë, rregullat janë shumë të qarta për
20 mua. Thotë që duhet të jepni listën e provave të propozuara që
21 Mbrojtja synon të paraqesë.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne kemi marrë qasjen, pra, synimi
23 për të përdorur është kategori e gjerë. Ka dokumente që
24 synojmë, kemi synimin për t'i përdorur në rrethanat e duhura.
25 Por jo që të gjitha do të hidhen si të tilla, si prova në

1 përgjithësi.

2 Vërej listën e provave materiale të ZPS-së që ka 21.000
3 materiale nga të cilat 8.600 janë paraqitur për t'u pranuar si
4 prova, pra, dy të tretat nuk janë paraqitur fare. ZPS-ja, ju e
5 dini që ZPS-ja mund të pretendonte që ishte shkaktuar dëm, por
6 Mbrojtja u vu në pozitën e tillë ku dhjetëra mijëra dokumente
7 duhet të trajtoheshin nga ajo dhe kjo nuk ka ndodhur
8 ndonjëherë. Pra, nuk mendoj që ka qenë praktikë, që po ndjekim
9 praktikën e ZPS-së ne, në shumë aspekte jemi përpjekur që të
10 përdorim ZPS-në si udhërrëfyes në një farë mënyre për mënyrën
11 sesi do të paraqesin provat tona.

12 Kam një çështje që dua të trajtoj.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju nuk më dhatë përgjigje
14 të saktë. Nuk mund të keni të dy qasjet apo të veproni në dy
15 mënyra të duhura. Nuk mendoj që mund të kritikoni Prokurorinë
16 nga njëra anë dhe pastaj të përdorni praktikën e tyre të mirë
17 për veten tuaj.

18 Ajo që kërkoj nga ju është që të më thoni qartë, është që
19 qëndrimi juaj i qartë, i kujdesur që i keni kushtuar listës,
20 pra, listës që na keni dhënë neve mbrëmë, me të gjitha
21 cilësimet që ka dhe që është e nevojshme në këtë fazë, pra, e
22 keni shqyrtuar atë siç duhet, faktin që shpresoni apo synoni
23 që të përdorë shprehjen, pra, i keni marrë parasysh rregullat
24 në rregullore për paraqitjen e provave.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Si përgjigje e kësaj do të thoja

1 që ne i kemi "kushtuar vëmendje" dhe ky është një term që ne
2 në bazë të cilit kemi punuar. Por me afatet për seanca të
3 ngjeshura me të cilat Trupi Gjykses na habiti neve në qershor,
4 çdo orë pune që kemi bërë për çdo person në ekipin e
5 Mbrojtjes, të gjithë kanë qenë duke punuar, si ju thashë, 12-
6 18 orë në ditë, përfshirë edhe gjatë fundjave.

7 Tani që të zvogëlojmë listën e provave materiale, mund të
8 kthehemi dhe të bëjmë një gjë të tillë, ta shqyrtojmë këtë dhe
9 në veçanti duhet të kemi parasysh që Mbrojtja ka pasur dhjetë
10 vjet për t'u përgatitur dhe për paraqitjen e provave të tyre,
11 ndërsa ne papritmas e befasisht kemi vetëm katër javë për të
12 bërë një gjë të tillë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pika e dytë, z. Misetic,
14 lidhur me dokumentet e ZPS-së. Kërkoj një sqarim nga ju, nëse
15 dëshironi mund ta përsërisë pyetjen, nuk është e qartë për mua
16 në veçanti dua të them që përtej parashtimit të z. Krasniqi,
17 të Mbrojtjes së z. Krasniqi. Nëse kuptojmë atë që na është
18 dhënë në fakt, ju keni mundësinë për të përdorur -- kërkon
19 mundësinë për të përdorur apo kërkon që të lejoheni të
20 përdorni çdo dokument që ka qenë në listën e provave materiale
21 të Prokurorisë, pa e patur ju në listën tuaj të provave
22 materiale? A e kuptoj që ky është parashtimi juaj?

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Problemi dhe këtu është që ne kemi
24 afate kohore shumë të ngjeshura dhe shumë të vështira, për aq
